

ARTICLES OF ASSOCIATION
of
SAUDI FALCON SHPK

CHAPTER I

DEFINITIONS; FORM; REGISTERED OFFICE;
NAME; DURATION; OBJECT

Article 1- Name and Definitions

1.1 In these Articles:

"Articles" means these articles of incorporation or articles of association of the Company, as amended or superseded from time to time.

"Business" has the meaning given in article 5.

"Business Day" means a day other than a weekend day (Saturday and Sunday) or other holiday, during which banks in Albania and Saudi Arabia are open for the transaction of normal business.

"Company" means Saudi Falcon SHPK.

STATUT
i
SAUDI FALCON SHPK

KAPITULLI I

PËRKUFIZIME; FORMA; SELIA;
EMRI; KOHËZGJATJA; OBJEKTI

Neni 1- Emri dhe Përkufizimet

1.1 Në këtë Statut:

"Statuti" është ky akt themelimi apo statut i Shoqërisë, i ndryshuar dhe zëvendësuar, rast pas rasti.

"Aktiviteti tregtar" ka kuptimin e dhënë në nenin 5.

"Ditë pune" është një ditë e ndryshme nga ditët e pushimit javor (e shtunë dhe e diel) ose ditët e festave zyrtare, gjatë të cilës bankat në Shqipëri dhe Arabi Saudite janë të hapura për kryerjen e transaksioneve të biznesit normal.

"Shoqëria" është Saudi Falcon SHPK.

J A

M A

<p>"Company Law"</p>	<p>"Ligji për Shoqëritë Tregtare"</p>
<p>means law no. 9901 dated 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies", as amended from time to time.</p> <p>"Connected Person"</p> <p>means, in relation to any person (the "Relevant Person"):</p> <p>(a) the Relevant Person's spouse or civil partner;</p> <p>(b) any other person (whether of a different sex or the same sex) with whom the Relevant Person lives as partner in an enduring family relationship;</p> <p>(c) the Relevant Person's children or step-children;</p> <p>(d) any children or step-children of a person within paragraph 0 (and who are not children or step-children of the Relevant Person) who live with the Relevant Person and have not attained the age of 18;</p> <p>(e) the Relevant Person's parents.</p>	<p>është ligji nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar kohë pas kohe.</p> <p>"Personi i Lidhur"</p> <p>është, në lidhje me çdo person ("Personi i Lidhur"):</p> <p>(a) bashkëshorti/ja ose partneri/ja e Personit të Lidhur;</p> <p>(b) çdo person tjetër (qoftë person i të njëjtës gjini apo gjinisë së kundërt) me të cilin Personi i Lidhur jeton si partner në një marrëdhënie të qëndrueshme familjare;</p> <p>(c) fëmijët dhe fëmijët e bashkëshortit/es të Personit të Lidhur;</p> <p>(d) çdo fëmijë ose fëmijë i partnerit/es të një personi sipas paragrafit b (dhe që nuk janë fëmijët ose fëmijët e bashkëshortit/es të Personit të Lidhur) që jetojnë me Personin e Lidhur dhe nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç;</p> <p>(e) prindërit e Personit të Lidhur.</p>

IA

MA

<p>“Control”</p> <p>means, the power of a person (or persons acting in concert) to secure that the affairs of another are conducted directly or indirectly in accordance with the wishes of that person (or persons acting in concert) whether by means of:</p> <p>(a) in the case of a company, being the beneficial owner of more than fifty percent (50%) of the issued share capital of or of the voting rights in that company, or having the right to appoint or remove a majority of the directors or otherwise control the votes at board meetings of that company by virtue of any powers conferred by the articles of association, General Assembly agreement or any other document regulating the affairs of that company; or</p> <p>(b) in the case of a partnership, being the beneficial owner of more than fifty percent (50%) of the capital of that partnership, or having the right to control the composition</p>	<p>“Kontrolli”</p> <p>është kompetenca e një personi (ose personave që veprojnë bashkërisht) për të siguruar që punët e palës tjetër do të kryhen drejtpërdrejtë ose tërthorazi në përputhje me vullnetin e atij personi (ose personave që veprojnë bashkërisht) qoftë nëpërmjet:</p> <p>(a) në rastin e një shoqërie, që është pronari përfitues i më shumë se pesëdhjetë përqind (50%) të kapitalit të emetuar të shoqërisë ose të drejtave të votës në shoqëri, ose që ka të drejtë të emërojë ose shkarkojë shumicën e drejtorëve ose ndryshe të kontrollojë votat në mbledhjet e Këshillit të kësaj shoqërie nëpërmjet të drejtave të parashikuara në Statut, marrëveshje të Asamblesë së Përgjithshme ose në çdo dokument tjetër që rregullon punët e kësaj shoqërie; ose</p> <p>(b) në rastin e një ortakërie, që është pronari përfitues i më shumë se pesëdhjetë përqind (50%) të</p>
---	---

I A

M A

	<p>of or the votes of the majority of the management of that partnership by virtue of any powers conferred by the partnership agreement or any other document regulating the affairs of that partnership, and "Controlled" shall be construed accordingly. For these purposes, "persons acting in concert", in relation to a person, are persons which actively cooperate, pursuant to an agreement or understanding (whether formal or informal) with a view to obtaining, maintaining or consolidating Control of that person.</p>
<p>"Encumbrance"</p>	<p>kapitalit të kësaj ortakërie ose që ka të drejtë të kontrollojë përbërjen ose votat e shumicës së drejtuesve të kësaj ortakërie nëpërmjet kompetencave të parashikuara në marrëveshjen e ortakërisë ose çdo dokument tjetër që rregullon punët e kësaj ortakërie, dhe "e Kontrolluar" do të interpretohet sipas rastit. Për këtë qëllim, "personat që do të veprojnë në bashkëpunim", në lidhje me një person, janë personat që bashkëpunojnë aktivisht sipas një marrëveshjeje ose mirëkuptimi (qoftë formale ose jo formale) për të marrë, ruajtur dhe forcuar Kontrollin e këtij personi.</p>
<p>means, any mortgage, charge, pledge, lien, option, restriction, right of first refusal, right of pre-emption, third party right or interest or other encumbrance or security interest of any kind, or another type of</p>	<p>"Barrë"</p> <p>është, çdo hipotekë, barrë, peng, opSION, kufizim, e drejtë refuzimi, e drejtë parablerje, e drejtë e palës së tretë ose interes ose barrë tjetër apo e drejtë interesi e çdo lloji, ose çdo</p>

JA

MA

	agreement or arrangement having similar effect including anything analogous to any of the foregoing under the laws of any jurisdiction.		marrëveshje tjetër që ka të njëjtin efekt përfshirë çdo gjë të ngjashme me sa më sipër sipas ligjeve të çdo juridiksioni.
"General Assembly"	means, the general assembly of Shareholders of the Company.	"Asambleja e Përgjithshme"	është asambleja e përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë.
"Administrator"	means any of the Administrators of the Company.	"Administrator"	është secili nga Administratorët e Shoqërisë.
"National Business Centre"	means <i>Qendra Kombëtare e Biznesit</i> , an Albanian public institution established by Law No. 131 of 26 November 2015 ("On the National Business Centre"), or its replacement from time to time.	"Qendra Kombëtare e Biznesit"	është <i>Qendra Kombëtare e Biznesit</i> , një institucion publik shqiptar, i themeluar me Ligjin Nr. 131, datë 26 nëntor 2015 ("Për Qendrën Kombëtare të Biznesit"), dhe ndryshimi i tij, rast pas rasti.
"Restricted Person"	means any person or entity that is mutually agreed by the parties; or is, in the reasonable opinion of the other Shareholders, or has been (or any of its affiliates are or have been) in breach of anti-bribery laws, sanctions, money laundering laws	"Person i Kufizuar"	është çdo person ose subjekt për të cilin është rënë dakord nga palët; ose, sipas gjykimit të arsyeshëm të Ortakëve të tjerë, është ose ka qenë (ose çdo Filial i tij është ose ka qenë) në shkelje të Ligjeve

J A

M A

<p>or any other laws and where an association with such person could result in material reputational damage to the Shareholder, any of its affiliates or the Company.</p> <p>“Shareholders” means, Ibrahim Saad M Ahamyani and Mohammed Saad M Alhamyani, or in the future, any natural and/or legal person owner of shares in the Company and “Shareholder” shall be construed accordingly.</p> <p style="text-align: center;">Article 2 - Legal Form</p> <p>2.1 The company is incorporated under the form of a limited liability company in the Republic of Albania and is organized and functions in compliance with the Company Law.</p> <p>2.2 In all the documents, invoices, advertisements and publications issued by the Company, regardless of the means for transmission, the name of the Company should be preceded or followed by the following:</p> <p style="padding-left: 40px;">i. the words <i>“Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”</i> or <i>“SHPK”</i>;</p>	<p>kundër mitmarrjes, sanksioneve, Ligjeve kundër Pastrimit të Parave ose çdo ligji tjetër dhe ku lidhja me këtë person mund t'i shkaktojë dëm material reputacionit të Ortakut, ndonjë prej Degëve të tij ose Shoqërisë.</p> <p>“Ortakë” është, Ibrahim Saad M Ahamyani dhe Mohammed Saad M Alhamyani, apo në të ardhmen, çdo person fizik dhe/ose juridik zotërues i kuotave në Shoqëri dhe “Ortaku” do të interpretohet sipas rastit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 2 – Forma ligjore</p> <p>2.1 Shoqëria është themeluar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Republikën e Shqipërisë dhe është e organizuar dhe funksionon në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.</p> <p>2.2 Në të gjitha dokumentet, faturat, reklamat dhe publikimet e lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyrat e transmetimit, emri i Shoqërisë duhet të paraprihet ose të pasohet si më poshtë vijon:</p> <p style="padding-left: 40px;">i. nga fjalët <i>“Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”</i> ose <i>“SHPK”</i>;</p>
---	---

IA

MA

<ul style="list-style-type: none"> ii. its unique identification number (NUIS); iii. the registered capital and the paid in capital of the Company; iv. the address of its registered seat; and v. a note that the Company is under liquidation, if applicable. 	<ul style="list-style-type: none"> ii. numrin e tij unik të identifikimit (NUIS); iii. kapitalin e regjistruar dhe kapitalin e paguar të Shoqërisë; iv. adresën e selisë; dhe v. një shënim që Shoqëria është në likuidim, nëse është e zbatueshme
<p>Article 3 - Registered Office</p>	<p>Neni 3 – Selia</p>
<p>3.1 The registered office of the company is at: Njësia në Zonën Kadastrale 1006, me sipërfaqe 105 m2, me vendndodhje në fshatin Ahmtraq Prezë.</p>	<p>3.1 Selia e Shoqërisë kompanisë është në: Njësia në Zonën Kadastrale 1006, me sipërfaqe 105 m2, me vendndodhje në fshatin Ahmtraq Prezë.</p>
<p>3.2 The Administrator may establish or close in Albania secondary addresses of the Company.</p>	<p>3.2 Administratori mund të hapë ose mbyllë në Shqipëri adresa dytësore të Shoqërisë</p>
<p>Article 4 – Name and Duration</p>	<p>Neni 4 – Emri dhe Afati</p>
<p>4.1 The name of the company is Saudi Falcon SHPK</p>	<p>4.1 Emri i shoqërisë është Saudi Falcon SHPK.</p>
<p>4.2 The Company will be of indefinite.</p>	<p>4.2 Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar.</p>
<p>Article 5 – Object of Activity</p>	<p>Neni 5 – Objekti i aktivitetit</p>
<p>5.1 Restaurant services, bar-café services, catering, sale of food and beverages, transportation of its own products.</p>	<p>5.1 Shërbime restoranti, shërbime bar-kafe, catering, shitje ushqimi dhe pijesh, transportim i produkteve të veta.</p>
<p>5.2 The Company may also carry out any other business or activities which are considered by the General Assembly being conveniently or advantageously carried on or done in connection with any of the above objects or calculated directly or</p>	<p>5.2 Shoqëria mund të kryejë gjithashtu çdo biznes ose aktivitet tjetër që konsiderohet nga Asambleja e Përgjithshme se zhvillohet ose kryet në mënyrë të përshtatshme ose të</p>

JA

MA

indirectly to enhance the value of or render more profitable any of the Company's Business, property or rights, in accordance with the Albanian legislation; and generally to do all such other things as may appear to the Company to be incidental or conducive to the attainment of the above objects or any of them.

CHAPTER II

SHARE CAPITAL; SHARES, AND VARIATION OF RIGHTS

Article 6 – Contributions

6.1 The initial registered capital of the Company is equal to ALL 100 (one hundred Albanian Lek) and consists of two shares (individually referred to as "Share" or collectively as "Shares").

6.2 The share capital will be paid in monetary value via bank transfer in one or more instalments in the bank account of the Company.

6.3 The shareholding structure of the Company is as follows:

Shareholders	No. of Shares	Total Value in Capital	Percentage of Share Capital

favorshme në lidhje me ndonjë nga objektet e mësipërme ose që është menduar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për të rritur vlerën ose për ta bërë më fitimprurës cilindo nga aktivitetet e Shoqërisë, pasurinë ose të drejtat e shoqërisë, në përputhje me legjislacionin shqiptar; dhe në përgjithësi të kryejë të gjitha veprimet e tjera që Shoqëria mund të gjykojë si shoqëruese e ose të favorshme për arritjen e objektivave të mësipërm ose ndonjë prej tyre.

KAPITULLI II

KAPITALI; KUOTAT DHE NDRYSHIMI I TË DREJTAVE

Neni 6 – Kontributet

6.1 Kapitali fillestar i regjistruar i Shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë dhe përbëhet nga 2 (dy) kuota (të referuara individualisht si "Kuota" ose bashkërisht si "Kuotat").

6.2 Kapitali do të paguhet në vlerë monetare me anë të transfertës bankare në një ose më shumë këste në llogarinë bankare të Shoqërisë.

6.3 Struktura e ortakëve të Shoqërisë është si më poshtë:

Ortakët	Numri i kuotave	Vlera e përgjithshme në Kapital	Përqindja në Kapital

JA

MA

Ibrahim Saad M Ahamyani	1	ALL 50	50 %
Mohammed Saad M Alhamyani	1	ALL 50	50 %

Ibrahim Saad M Ahamyani	1	50 LEK	50%
Mohammed Saad M Alhamyani	1	50 LEK	50%

Article 7 – Rights

- 7.1 The Shares, shall confer on their holders:
- (i) the right to receive notice of and to attend and vote at all General Assembly meetings of the Company and exercise any other rights related to the shares under the Company Law; and
 - (ii) the right to receive dividends or other distributions in proportion to the value of the Shares in the share capital of the Company (if the General Assembly takes such decisions).

Article 8 – Restrictions on Share Disposal

- 8.1 With the exception of the provision under paragraph 2, no Shareholder shall do, or agree to do, any of the following without the prior written approval of the General Assembly:
- a. sell, donate, assign, transfer or otherwise dispose of, or grant any option over, any of its Shares or any legal or beneficial interest in any of its Shares;
 - b. create or permit to subsist any Encumbrance over any of its Shares or any interest in any of its Shares;

Neni 7 – Të drejtat

- 7.1 Kuotat do t'u japin zotëruesve të tyre:
- (i) të drejtën për t'u njoftuar dhe për të marrë pjesë dhe votuar në të gjitha mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë dhe për të ushtruar çdo të drejtë tjetër që lidhet me kuotat sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare; dhe
 - (ii) të drejtën për të marrë dividendë ose shpërndarje të tjera në përpjesëtim me vlerën e kuotave në kapitalin e Shoqërisë (nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendime të tilla).

Neni 8 – Kufizimet për Shitjen e Kuotave

- 8.1 Me përjashtim të parashikimeve të paragrafit 2, asnjë Ortak nuk do të bëjë, ose të pranojë të bëjë, ndonjë nga sa më poshtë vijon pa miratimin paraprak me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme:
- a. të shesë, dhurojë, caktojë, transferojë ose japë në ndonjë mënyrë tjetër, ose të japë ndonjë të drejtë/opsion lidhur me ndonjë prej Kuotave të tij ose ndonjë interes

IA

MA

<p>c. create any trust in respect of or confer any interest in any of its Shares or any interest in any of its Shares;</p> <p>d. enter into any agreement, arrangement or understanding in respect of the votes or the right to receive dividends or any other rights attached to any of its Shares;</p> <p>e. allow any Restricted Person to acquire any interest, directly or indirectly, through one or more subsidiaries, or through any agreement that grants an interest in, or confers a benefit derived from an interest in, itself or any Company.</p>	<p>ligjor ose përfitues për ndonjë prej Kuotave të tij;</p> <p>b. të krijojë ose të lejojë që të ekzistojë ndonjë Barrë mbi ndonjë nga Kuotat tij ose ndonjë interes në ndonjë nga Kuotat e tij;</p> <p>c. të krijojë ndonjë <i>trust</i> në lidhje me ose të japë ndonjë interes në ndonjë nga Kuotat e tij;</p> <p>d. të lidhë ndonjë marrëveshje, të ndër marrë ndonjë angazhim ose mirëkuptim lidhur me votat ose të drejtën për të marrë dividendë ose çdo të drejtë tjetër që i bashkëngjitet ndonjë prej Kuotave të tij;</p> <p>e. të lejojë çdo Person të Kufizuar të fitojë ndonjë interes, drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë, nëpërmjet një ose më shumë filialeve, ose nëpërmjet ndonjë marrëveshjeje që jep një interes ose jep një përfitim i cili rrjedh nga një interes në vetvete ose në ndonjë Shoqëri.</p>
<p>8.2 Paragraph 1 of this article shall not apply to any transfer made to a Connected Person at any time requiring only written notice to the other Shareholder, copied to the Company.</p>	<p>8.2 Paragrafi 1 i këtij neni nuk do të zbatohet për asnjë transferim të bërë te një Person i Lidhur në çdo kohë që kërkon vetëm njoftimin me shkrim për ortakun tjetër, i cili i dërgohet edhe Shoqërisë.</p>
<p>Article 9 – Buy Out Provisions</p>	
<p>9.1 Each Shareholder shall have the right to purchase the entire Share of the other Shareholder. The Shareholder which intends to execute the buyout right shall give to the other Shareholder a written notice. Within 30 (thirty) days from the day when written notice is given to the other Shareholder, both Shareholders will meet to discuss in good faith on how to resolve any disputes in order to prevent a buyout. Should the Shareholders not agree on preventing the buyout within 30 (thirty) days from the day when the Shareholders</p>	<p>Neni 9 – Parashikime për Blerjen</p> <p>9.1 Çdo Ortak ka të drejtë të blejë të gjithë Kuotën e Ortakut tjetër. Ortaku i cili synon të zbatojë të drejtën e blerjes do t'i japë një njoftim me shkrim ortakut tjetër. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e dhënies së njoftimit me shkrim Ortakut tjetër, të dy Ortakët do të takohen për të diskutuar në mirëbesim se si të zgjidhin çdo mosmarrëveshje për të parandaluar një blerje. Nëse Ortakët nuk bien dakord</p>

JA

MA

<p>have started or should have started discussions in accordance with the deadline provided above, either Shareholder has the right to make a formal buy-out proposal at the terms provided as follows.</p>	<p>për parandalimin e blerjes brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita kur Ortakët kanë filluar ose duhet të kishin filluar diskutimet në përputhje me afatin e parashikuar më sipër, secili prej Ortakëve ka të drejtë të bëjë një propozim zyrtar për blerje me kushtet e parashikuara më poshtë.</p>
<p>9.2 The Shareholder that initiates the formal buyout proposal (the “Offeror”) has to propose in written notice a price at which to purchase the other Shareholder’s share in the Company (the “Offeree”). Within 30 (thirty) days from the day when written notice is given, the Offeree has the obligation to either: (i) accept the offer to sell its share of interest in the Company to the Offeror at the proposed price, or (ii) to make a counteroffer to purchase the share in the Company of the Offeror at a higher price. The Shareholders may continue to “shoot” counter offers to buy-out each other until the moment that one of the Parties agree to sell its Share in the Company, provided that counteroffers should not be lower than the value of the preceding offer increased by 5%. Failure to respond to the proposal or any counteroffer within the indicated deadline constitutes acceptance of the said proposal or counteroffer. Once the buyout has been agreed by the Shareholder deciding to sell in the written notice, the Shareholders shall sign a written share purchase agreement within 30 days starting from the day when written notice is given. The payment of the price shall be made not later than 60 (sixty) Business Days from the day when the share purchase agreement is signed, unless the Shareholders agree otherwise.</p>	<p>9.2 Ortaku që nis propozimin formal të blerjes (“Ofruesi”) duhet të propozojë me anë të njoftimit me shkrim një çmim me të cilin do të blejë kuotat e Ortakut tjetër në Shoqëri (“Marrësi i Ofertës”). Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e dhënies së njoftimit me shkrim, Marrësi i Ofertës ka detyrimin që: (i) të pranojë ofertën për t’i shitur kuotën e tij në Shoqëri Ofruesit me çmimin e propozuar, ose (ii) të bëjë një kundërofertë për të blerë Kuotën e Ofruesit në Shoqëri me një çmim më të lartë. Ortakët mund të vazhdojnë t’i “dërgojnë” kundërofertat njëri-tjetrit për të blerë deri në momentin që njëra nga Palët bie dakord të shesë Kuotën e saj në Shoqëri, me kusht që kundërofertat të mos jenë më të ulëta se vlera e ofertës së mëparshme e rritur me 5%. Mospërgjigja ndaj një propozimi ose kundëroferë brenda afatit të përcaktuar përbën pranimin e propozimit ose kundërofertës në fjalë. Pasi blerja të jetë rënë dakord nga Ortaku që vendos të shesë në njoftimin me shkrim, ortakët do të nënshkruajnë një marrëveshje me shkrim për blerjen e kuotave brenda 30 ditëve duke filluar nga dita kur është dhënë njoftimi me shkrim. Paga e çmimit do të bëhet jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) Ditë Pune nga dita e nënshkrimit të</p>

JA

MA

<p>9.3 In case that the Shareholder that has exercised its buyout right fails to purchase the shares of the selling Shareholder, such defaulting Shareholder shall lose its buyout right and consequently the other Shareholder (non-defaulting Shareholder) shall be entitled to purchase the shares of the defaulting Shareholder for the latest price offered for such shares by the non-defaulting Shareholder when exercising its buyout right. The defaulting Shareholder is liable for the fulfillment of its obligations under this article and in case it refuses to proceed with the purchase of the Put Option Shares it is required to pay 20% of the value of the buyout as a penalty for failure to complete the purchase as well as pay any additional damage, cost or expense related to such failure.</p>	<p>marrëveshjes për blerjen e kuotave, përveç nëse Ortakët bien dakord ndryshe.</p>
<p>9.4 In the event that the Shareholder that has exercised its buy-out right (the “Buying Shareholder”) and executed with the other Shareholder (the “Selling Shareholder”) a share purchase agreement, sells to a third person the purchased share for a value exceeding the sale price by at least 25% within 12 (twelve) months from the execution of the buyout share purchase agreement, thereafter the Buying Shareholder shall equally divide the capital gain realized from such sale with the Selling Shareholder.</p>	<p>9.3 Në rast se Ortaku që ka ushtruar të drejtën e tij të blerjes nuk blen kuotat e Ortakut shitës, ky Ortak që nuk e ka përmbushur detyrimin do të humbasë të drejtën e tij të blerjes dhe rrjedhimisht Ortaku tjetër (Ortaku që ka përmbushur detyrimet) do të ketë të drejtë të blejë kuotat e Ortakut me çmimin më të fundit të ofruar për këto kuota nga ortaku që ka përmbushur detyrimet kur ushtron të drejtën e tij të blerjes. Ortaku që ka përmbushur të detyrimet është përgjegjës për përmbushjen e tyre të tij sipas këtij neni dhe në rast se refuzon të vazhdojë me blerjen e Kuotave të Opsionit të Shitjes, kërkohet të paguajë 20% të vlerës së blerjes si një penalitet për mos blerje si dhe të paguajë çdo dëm shtesë, kosto ose shpenzim në lidhje me këtë.</p> <p>9.4 Në rast se Ortaku që ka ushtruar të drejtën e tij të blerjes (“Ortaku Blerës”) dhe ka nënshkruar me Ortakun tjetër (“Ortaku Shitës”) një marrëveshje për blerjen e kuotave, i shet një personi të tretë kuotën e blerë për një vlerë që tejkalon çmimin e shitjes me të paktën 25% brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga nënshkrimi i marrëveshjes për blerjen e kuotës, më pas, Ortaku Blerës do të ndajë në mënyrë të barabartë fitimin në kapital të realizuar nga kjo shitje me Ortakun Shitës.</p>
<p>Article 10 – Capital Increase and Decrease</p>	<p>Neni 10 - Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit</p>
<p>10.1 The capital may be increased or decreased through a resolution of the General Assembly.</p>	<p></p>

J A

M A

<p>10.2 The capital may be increased or decreased in all the manners and in accordance with the procedures provided by the Company Law or in the resolution of the General Assembly as far as it is in compliance with the Company Law.</p> <p>10.3 The Company's shareholders have the right to participate in the increase and decrease of the shared capital of the Company, in proportional measure to their participation in the capital of the Company.</p>	<p>10.1 Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.</p> <p>10.2 Kapitali mund të zmadhohet ose zvogëlohet në të gjitha mënyrat dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare ose në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme për aq sa është në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.</p> <p>10.3 Ortakët e Shoqërisë kanë të drejtë të marrin pjesë në zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.</p>
<p><u>CHAPTER III</u></p>	<p><u>KAPITULLI III</u></p>
<p><u>CORPORATE STRUCTURE</u></p>	<p><u>STRUKTURA E SHOQËRISË</u></p>
<p>Article 11 – Corporate Structure</p> <p>11.1. The Company is structured with the following corporate bodies:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. General Assembly of Shareholders; and b. Administrator(s). 	<p>Neni 11 – Struktura e Shoqërisë</p> <p>11.1. Shoqëria është e strukturuar me organet e mëposhtme të shoqërisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve; dhe b. Administratori(ët).
<p>Article 12 – General Assembly</p>	<p>Neni 12 – Asambleja e Përgjithshme</p>
<p>12.1 The General Assembly is the supreme body of the Company and it has the right to take decisions on all issues of the Company in accordance with the Company Law. It has the right to review the validity of any decision of the Administrator(s), and if necessary, annuls them in case of incompatibility with the Articles of Association and the Company Law.</p>	<p>12.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë i Shoqërisë dhe ka të drejtë të marrë vendime për të gjitha çështjet e Shoqërisë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë tregtare. Ajo ka të drejtë të shqyrtojë vlefshmërinë e çdo vendimi të Administratorit(ve), dhe nëse është e nevojshme, t'i anulojë ato në rast</p>

IA

MA

<p>12.2 The General Assembly decides on the following matters:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. amendment of the Articles of Association; b. acceptance of new shareholders (after an increase in the registered capital or a transfer of shares); c. increase and/or decrease the registered capital; d. resolve on a merger, spin-off, dissolution and any kind of transformation of the Company; e. establish and/or close down branches and representation offices; f. subscription and acquisition of shares in other entities or transfer or creation of any encumbrance or any other charge over any shares held by the Company in any other entities; g. supervise the implementation of the commercial policies by the administrator(s) and or any other body of the Company; h. approve the annual financial statements and balance sheet, the business plan and approve the distribution of profit and/or coverage of losses; i. appoint and dismiss the administrator(s); j. resolve on the internal rules of the management; k. file suits against the administrator(s) of the Company; l. resolve on the sale and Encumbrance of assets exceeding five percent of the value of the Company assets resulting from the latest financial statements; 	<p>papajtueshmërie me Statutin dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.</p> <p>12.2 Asambleja e Përgjithshme vendos për çështjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. ndryshimin e Statutit; b. pranimin e ortakëve të rinj (pas zmadhimit të kapitalit themeltar ose transferimit të kuotave); c. zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit të themeltar; d. të vendosë për bashkimin, ndarjen, prishjen dhe çdo lloj transformimi të Shoqërisë; e. të themelojë dhe/ose mbyllë degët dhe zyrat e përfaqësimit; f. nënshkrimin dhe blerjen e kuotave në subjektet të tjera ose transferimin ose krijimin e ndonjë barre ose ndonjë detyrimi tjetër mbi ndonjë kuotë të mbajtur nga Shoqëria në ndonjë subjekt tjetër; g. të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare nga administratori(ët) dhe ose çdo organ tjetër i Shoqërisë; h. të miratojë pasqyrat financiare vjetore dhe bilancin, planin e biznesit dhe miratojë shpërndarjen e fitimit dhe/ose mbulimin e humbjeve; i. emërojë dhe shkarkojë administratorin(ët); j. vendosë për rregullat e brendshme të administrimit; k. të ngrejë padi kundër administratorit(ve) të Shoqërisë; l. të vendosë për shitjen dhe Barrësimin e aktiveve që tejkalojnë pesë për qind të vlerës së aktiveve
--	---

JA

MA

<p>m. determine the remuneration of the administrator(s);</p> <p>n. resolve on the appointment of auditors;</p> <p>o. approve the management and administrative organisation of the Company;</p> <p>p. decide on any other matters which has been reserved to the General Assembly by the Company Law and/or these Articles of Association.</p> <p>12.3 The General Assembly is entitled to decide on any additional matter which is not explicitly the competence of any other body under the Company Law or these Articles of Association.</p> <p>Article 13 - General Assembly Meetings</p> <p>13.1 Convening General Assembly Meetings</p> <p>The Administrator may convene a General Assembly meeting at any time. In any case, the General Assembly meeting shall be called at least once a year, no later than June of each year in order to discuss, review and approve the Company's annual financial statements. The Shareholders shall hold the General Assembly meeting at such place as the person/body convoking the meeting determines but reserving the possibility for each Shareholder to participate via electronic means in accordance with article 13.5 below.</p>	<p>të Shoqërisë që rezulton nga pasqyrat e fundit financiare;</p> <p>m. të përcaktojë shpërblimin e administratorit(ve);</p> <p>n. të vendosë për emërimin e ekspertëve kontabël;</p> <p>o. miratojë organizimin drejtues dhe administrativ të Shoqërisë;</p> <p>p. të vendosë për çdo çështje tjetër, që në bazë të Ligjit për Shoqëritë e Tregtare dhe/ose këtë statut, është në kompetencën e Asamblesë së Përgjithshme.</p> <p>12.3 Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të vendosë për çdo çështje shtesë e cila nuk është në mënyrë të qartë kompetencë e ndonjë organi tjetër sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare ose këtij Statuti.</p> <p>Neni 13 – Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme</p> <p>13.1 Thirrja e Mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme</p> <p>Administratori mund të thërrasë një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme në çdo kohë. Në çdo rast, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të thirret të paktën një herë në vit, jo më vonë se qershori i çdo viti, për të diskutuar, shqyrtuar dhe miratuar pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë. Ortakët do të mbajnë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme në një vend të përcaktuar nga personi/organi i cili thërret mbledhjen, por duke i dhënë mundësinë secilit Ortak të marrë pjesë nëpërmjet</p>
---	--

JA

MA

